



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 21.03.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **17.03.2025**, të parashtruar nga oe **MATKOS PHARM SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me Barna nga LE" Lot-3 (Dexamethasone)** me nr. prokurimi **206-24-13247-1-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e **MATKOS PHARM SH.P.K.**, e dt. 17.03.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me Barna nga LE" Lot-3 (Dexamethasone)** me nr. prokurimi **206-24-13247-1-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK të datës 11.03.2025;
2. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi vendimin e AK i datës 11.03.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

MATKOS PHARM SH.P.K., me datën 17.03.2025 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim për aktivitetin e prokurimit me titull **"Furnizim me Barna nga LE" Lot-3 (Dexamethasone)** me nr. prokurimi **206-24-13247-1-1-1**. Autoriteti Kontraktues bazuar në sqarimet e dhëna nga AKPPM, me datë 21.03.2025 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

Neni 17 i Rregullores NR.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK lidhur me nenin 20 (Valuta dhe Kalkulimi i Çmimit) të dosjes së tenderit.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Me datë 11.03.2025 jemi njoftuar nga AK përmes B58 Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues, ku jemi njoftuar se jemi eliminuar për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me barna nga Lista Esenciale – LOT 3". Përmes këtij njoftimi jemi njoftuar se jemi eliminuar për arsye se kemi ofertuar me çmim më të lartë se OE i rekomanduar për kontratë. Mirëpo pasi kemi analizuar ofertën e OE të rekomanduar "N.SH. DRENI PHARM", kemi vërejtur se ky OE ka dorëzuar "Marketing Authorisation" të pa vlefshëm sepse është dokument pa vulë dhe pa nënshkrim. Dokumenti si i tillë, në mungesë të vulës dhe nënshkrimit nuk mund të pranohet sepse nuk është dokument zyrtar që vërteton se kush e ka prodhuar dokumentin. Andaj, një dokument apo licencë e cila nuk ka vulë dhe nënshkrim nuk mund të pranohet në procedurë. Pra Autorizimi për Marketing meqë nuk ka vulë dhe nënshkrim nuk mund të pranohet dhe në mungesë të këtij autorizimi, tenderi i OE të rekomanduar është i papërgjegjshëm sepse nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit, ashtu siç është kërkuar në pikën 9.1 & 9.2 (Kërkesat mbi mundësitë teknike), konkretisht kërkesa 2. e Kapacitetit teknik dhe profesional të dosjes së tenderit.

Gjithashtu, gjatë analizimit të ofertës financiare të OE të rekomanduar, komisioni i vlerësimit nuk e ka bërë vlerësimin sipas nenit 59 të LPP-së sepse çmimi final i OE të rekomanduar është 153,700.33 euro ($1\,714\,640 \text{ cope} \times 0,083 \text{ cent} = 142,315.12 \text{ euro}$ pa TVSH $\times 8\% = 153,700.33 \text{ euro}$).

Andaj, kërkojmë që gjatë shqyrtimit të kërkesës tonë të bëni anulimin e vendimit tuaj dhe gjatë rivlerësimit të zbatoni në tërësi nenin 59 të LPP-së.

Dëmet materiale: Nuk ka.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

E kemi shqyrtuar pretendimin e juaj ankimore ne lidhje me AM e ofruar nga OE i rekomanduar per Lot-3 (Dexamethasone) dhe kete çështje e kemi sqaruar me AKPPM dhe pas sqarimit nga AKPPM konstatojmë se ky pretendim i juaji ankimore eshte i pa bazuar.

Sqarimi nga zyrtarja përgjegjëse e AKPPM-se ka qene se: Ju konfirmoj qe produkti Dexamethasone RMA-3332/29/03/2023 ka validitet dhe eshte ne listen e produkteve me MA certifikata. Certifikata e paraqitur nga juaj eshte nga gjeneruar nga sistemi i cili ne ate kohe moduli I ripërtrirjeve ne sistemin barnatari ka qene inaktiv, per kete arsye te gjitha certifikatat mund te shkarkohen pa nenshkrim para aktivizimit te modulit te digjitalizuar.

Ju lutem qe te gjeni te bashkengjitur certifikaten valide me nenshkrim te cilen poashtu mund ta kerkoni edhe nga pala qe te paraqes certifikaten e marre ne kopjen fizike.

Gjithashtu nga AKPPM na eshte dërguar edhe AM për këtë produkt i aprovuar dhe me dokumentacionin përcjellës te prodhuesit prej 60 faqe, shih dokumentin ne vijim:



Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
Kosovo Medicines Agency
Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva

Renewal Marketing Authorisation Certificate

MA Holder: Deutsche Labs., Inc, India
RMA No: RMA 3332/29/03/2023
Date of Print: 29/03/2023

Based on, the provisions of the Law No.04/L-190 On 'Medicinal Products and Medical Devices' and, Administrative Instruction (Health) No.1/2015 issues to applicant:

For medicinal product

Product Trade Name: Dexamethasone sodium Phosphate Injection USP
INN: Dexamethasone
Manufacturer: Deutsche Labs., Inc, India
Pharmaceutical Form & Strength: Solution for injection, 4mg/ml (Dexamethasone sodium phosphate)
Pack Size: Box containing 10 ampoules of 1ml
ATC Code: H02AB02
Expiry date: 29/03/2028

This medicinal product, based on the approved Application documentation, Summary of Product Characteristics and Patient Information Leaflet, submitted by applicant, is permitted to be placed in Kosovo for a period of 5 years.
The Holder of the Renewal Marketing Authorisation swears that the documentation and samples concerning the medicinal product are valid at the day issuance of this Renewal Marketing Authorisation Certificate and shall be valid for the duration of this Certificate, unless an application for a variation is made and approved by issuing authority.

Copy to:

Sejdë Tolaj

Acting Chief Executive Officer

2 The RMA archive



Sa i përket pretendimit rreth ofertës financiare te OE te rekomanduar, mos vlerësimi si duhet te çmimit me decimale dhe kalkulimeve, konstatojmë se ky pretendim ankimore është pjesërisht i bazuar dhe ne si AK do ti rishikojmë çmimet e ofertës dhe decimalet e plotësuar dhe nëse është e nevojshme do e bëjmë korrigjimin e Njoftimit mbi vendimin e AK te datës 11.03.2025;

Si përfundim, bazuar ne sqarimet e dhëna nga AKPPM, konsiderojmë se kërkesa juaj për rishqyrtim është e pa bazuar dhe nuk ka baze për zhagjitjen e procesit dhe vonese për furnizimin e këtij produkti.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit te këtij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. MATKOS PHARM SH.P.K.,
2. Operatoreve ekonomik te interesuar



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit